

KËSHILLI I MINISTRAVE
Projekt - V E N D I M

PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË ZHVENDOSJES DHE TË
BASHKËPUNIMIT INSTITUCIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Procedurat e zhvendosjes respektojnë parimet e mëposhtme:

1.1 Procedurat e zhvendosjes realizohen në respektim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si dhe të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara në RSH, përfshirë të drejtën për kushte të përshtatshme strehimi.

1.2. Të gjithë individët/familjet e prekura nga zhvendosja gëzojnë mbrojtje juridike të njëjtë, pavarësisht nëse gëzojnë apo jo titull pronësie mbi banesën apo pronën nga e cila zhvendosen, në përputhje me ligjin 22/2018.

1.3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjatë procedurës së zhvendosjes, respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të gjitha të drejtat dhe lirië themelore të njeriut, duke garantuar që:

- a. individët/familjet që i nënshtrohen procedurës së zhvendosjes përfitojnë strehim të përshtatshëm sipas përcaktimeve në ligjin nr. 22/2018 si dhe gëzojnë mjetin ligjor mbrojtës ndaj vendimmarrjes për zhvendosje të parashikuar nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi.
- b. strehimi i përshtatshëm i garantohet, në përputhje me ligjin 22/2018, pa diskriminim të asnjë lloji mbi bazë gjinie, race, feje, etnie, gjuhe, bindje politike, fetare a filozofike, gjendje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ngjyre, shtetësie, orientimi seksual, shtatzënie, përgjegjësie prindërore, moshe, gjendje familjare ose martesore, gjendje civile, vendbanimi, gjendje shëndetësore, predispozicioni gjenetik, aftësie të kufizuar, përkatësie në një grup të veçantë, ngjyre, ose për çdo shkak tjetër, cilitdo individ/familje që i nënshtrohen procedurës së zhvendosjes.
- c. individ/familja që nuk gëzon të drejtën e pronësisë gëzon të drejtën për risistemim dhe ristrehim duke i dhënë prioritet dhënies së një strehimi në përputhje me këto kritere përshtatshmërie: aksesimi, çmimi i përbalueshëm, kushtet e banimit, siguria e zotërimit, përshtatshmëria kulturore dhe aksesimi ndaj shërbimeve thelbësore, si kujdesi shëndetësor dhe arsimit.
- d. individ/familja që gëzon të drejtën e pronësisë mbi pronën nga e cila zhvendoset gëzontë drejtën për kompensim të drejtën në përputhje me legjislacionin për shpronësimet.

1.4. Procedura e zhvendosjes duhet të respektojë sa vijon:

- a. realizohet në përputhje me parashikimet e ligjit 22/2018;
- b. kryhet në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të ratifikuara me ligj;
- c. kryhet vetëm për qëllim të përkrahjes së mirëqenies së përgjithshme;
- d. është e arsyeshme dhe proporcionale;
- e. miratohet dhe zbatohet në mënyrë të tillë që të mundësojë kompensim të drejtë.

1.5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në aktet që përmbajnë fitimin e pronësisë dhe të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme përfshijnë shprehimisht referimin e identitetit dhe cilësimit si bashkëpronar të secilit anëtar madhor të familjes dhe/ose të dy bashkëshortëve në përputhje me Kodin e Familjes dhe ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

1.6. Individit/familja ndaj të cilës nis procesi administrativ i zhvendosjes nuk duhet të pësojë kthimin në të pastrehë ose vulnerabël ndaj shkeljes së të drejtave të tjera të njeriut. Njësia e vetëqeverisjes vendore garanton dhe ofron një strehim të përshtatshëm alternativ, risistemim në një vend tjetër ose akses në tokë prodhuese, sipas rastit, sa më pranë vendbanimit fillestar dhe burimit të jetesës së të zhvendosurve.

1.7. Njësia e vetëqeverisjes vendore merr të gjitha masat për risistemim, si ndërtimi i banesave, sigurimi i ujit, energjisë elektrike, higjienës, shkollave, aksesit në rrugë dhe caktimi i tokës dhe i shesheve, në pajtim me këto udhëzime dhe parimet e politikave të strehimit, përcaktuar në ligjin nr. 22/2018 dhe i përfundon ato përpara se individit/familja të zhvendosen nga banesat e tyre fillestare.

2. Procedura e zhvendosjes realizohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

2.1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ngre njësinë përgjegjëse/grupin e punës për ndjekjen e një procedure konkrete zhvendosjeje, duke përfshirë në të edhe punonjës nga drejtoritë përgjegjëse për planifikimin e territorit, strehimin, buxhetin dhe cakton një nënkryetar të njësisë së vetëqeverisjes vendore si koordinator të njësisë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë në mënyrë të detajuar veprimitarinë e këtyre grupeve të punës në rregulloret e tyre të brendshme.

2.2. Në vendimin/urdhrin e ngritjes së grupit të punës përcaktohet emri i drejtuesit/es së kësaj njësie përgjegjëse. Emri/mbiemri dhe kontakti i drejtuesit/ese dhe i të gjithë anëtarëve të grupit të punës i njoftohet individit/familjes me fillimin e procedimit administrative të zhvendosjes.

3. Individët/familjet që preken nga zhvendosja përfitojnë ndihmë juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

3.1. Njësia e vetëqeverisjes vendore, në aktin e njoftimit individit/familjes për fillimin e procedurave administrative të zhvendosjes, njoftojnë ata edhe për mundësinë e përfitimit nga ndihma juridike e garantuar nga shteti, duke informuar për organin publik të krijuar për ofrimin e kësaj ndihme, si dhe kontaktin e këtij organi.

4. Njësia e vetëqeverisjes vendore zbaton zhvendosjen pasi siguron sistemimin me strehim të përshtatshëm të individëve/familjeve që zhvendosen dhe nuk përfitojnë shpërblim në përputhje me procedurat e shpronësimit.

4.1. Njësia e vetëqeverisjes vendore informon individin/familjen për mundësitë alternative të strehimit dhe kërkon mendimin e individit/familjes për aplikimin e një prej këtyre

mundësive. Mendimi i individit/familjes vlen si një prej rrethanave këshilluese për njësinë e vetëqeverisjes vendore në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të organit publik për aplikimin e mundësisë së strehimit.

4.2. Njësia e vetëqeverisjes vendore ofron atë mundësi strehimi të përshtatshëm që përdor maksimumin e burimeve të njësisë vendore.

4.3. Ofrimi i subvencionimit të qirasë si mundësi strehimi, realizohet vetëm pasi njësia e vetëqeverisjes vendore ka siguruar banesat në pronësi të pronarit social dhe lidhjen e kontratës me pronarin social.

5. Për çdo individ/familje të zhvendosur, njësia e vetëqeverisjes vendore miraton një plan të hollësishëm të zhvendosjes, në të cilin përfshihen të gjitha elementet e vlerësimit, masat e identifikuar për risistemim, rikthim, rehabilitim si dhe formën e miratuar për strehim alternativ.

5.1. Plani i zhvendosjes i njoftohet individit/familjes 30 ditë para nxjerrjes së aktit administrativ të zhvendosjes.

6. Njësia e vetëqeverisjes vendore miraton vlerësimin e “ndikimit të zhvendosjes” ku përfshihet edhe shqyrtimi i alternativave dhe strategjive për minimizimin e dëmit.

6.1. Njësia e vetëqeverisjes vendore më së pari synon të arrijë një marrëveshje administrative me shkrim me individin/familjen ndaj të cilës do të miratojë vendimin e zhvendosjes për alternativën e përshtatshme të strehimit të propozuar. Nëse nuk realizohet një marrëveshje e tillë, njësia e vetëqeverisjes vendore vijon procedurën e zhvendosjes.

7. Procedura e zhvendosjes realizohet duke respektuar procesin e rregullt ligjor.

7.1. Njësia e vetëqeverisjes vendore njofton me shkrim individin/familjen për arsyet e zhvendosjes 30 ditë para nxjerrjes së aktit administrativ për zhvendosjen nga banesa.

Njoftimi përmban këto të dhëna:

- a. arsyet e zhvendosjes nga banesa;
- b. adresën postare dhe/ose elektronike të organit publik të njësisë së vetëqeverisjes vendore, që zhvillon procedurën dhe emrin/at e nëpunësit/sve përgjegjës për këtë procedurë;
- c. informacion lidhur me kompetencën e njësisë së vetëqeverisjes vendore për procedurën e zhvendosjes, qëllimin e procedurës dhe çështjet për të cilat do të merren vendime;
- d. informacionin për mundësitë alternative të strehimit;
- e. saktësimin e individit/familjes palë në procedurën administrative të zhvendosjes;
- f. informacion për të drejtën e individit/familjes të njohjes së dosjes së krijuar për procedurën e zhvendosjes dhe zyrën ose vendin ku mund të njihet dosja;
- g. informacion për të drejtën e individit/familjes për t'u dëgjuar para nxjerrjes së aktit administrativ të zhvendosjes, përfshirë mënyrat dhe afatin e ushtrimit të kësaj të drejte.

7.2. Njësia e vetëqeverisjes vendore brenda afatit 30 ditor sipas pikës 7.1 ka barrën e shfrytëzimit të të gjitha mjeteve të kërkimit të provave administrative për mbledhjen e të gjitha provave të nevojshme për nxjerrjen e një akti objektiv administrativ të zhvendosjes në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Të gjitha dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ për zhvendosjen e individit/familjes, administrohen kryesisht nga njësia

përgjegjëse e caktuar për realizimin e procedurës administrative të zhvendosjes, kur janë në administrim të njësisë së vetëqeverisjes vendore që po realizon këtë procedurë ose edhe kur janë në administrim të cilitdo organi tjetër publik në Republikën e Shqipërisë. Në rast nevoje, njësia përgjegjëse mund t'i kërkojë individit/familjes elementet e nevojshme për identifikimin e këtyre provave.

7.3. Individit/familja që njoftohet për arsyet e zhvendosjes sipas pikës 7.1. ka të drejtë të kërkojë nga njësia e vetëqeverisjes vendore kryerjen e një inventari për të llogaritur vlerën e pasurive të tyre, investimeve dhe të mirave të tjera materiale që mund të dëmtohen nga zhvendosja si dhe për të vlerësuar dhe dokumentuar humbjet jo monetare që do të kompensohen.

7.4. Individit/familja ndaj të cilës nis procesi administrativ i zhvendosjes ka të drejtën e zhvendosjes së pasurive që mund të shpëputen nga prona para prishjes së saj për të minimizuar dëmet e shkaktuara. Shpenzimet në raste të tilla përballohen nga fondet e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

8. Akti administrativ për zhvendosjen miratohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore pas 30 ditëve pas njoftimit të arsyeve të zhvendosjes sipas pikës 7.1 të këtij vendimi.

8.1. Akti administrativ për zhvendosjen përmban edhe:

- a. Individin/familjen palë të cilës u drejtohet;
- b. datën e miratimit;
- c. arsyetimin e zhvendosjes;
- d. kohën e hyrjes në fuqi të aktit;
- e. formën e miratuar për strehim;
- f. përcaktimin e mjetit ligjor mbrojtës së individit/familjes ndaj këtij akti, përkatësisht mjetin e ankimit, gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, afatin dhe mënyrën e përlogaritjes së afatit për paraqitjen e ankimit.

9. Akti administrativ për zhvendosjen ekzekutohet vetëm me kalimin e 45 ditëve nga njoftimi i tij individit/familjes që do të zhvendoset.

9.1. Personi/at përgjegjës i/të ngarkuar me ekzekutimin e aktit administrative të zhvendosjes identifikohet/n përpara individit/personave që po zhvendosen dhe paraqesin autorizimin zyrtar për zhvendosjen.

9.2. Njësia e vetëqeverisjes vendore njofton në faqen e vet të internetit apo në buletinë vendor procedurën e zhvendosjes për të gjitha palët e interesuara në proces.

9.3. Gjatë zhvendosjes njësia e vetëqeverisjes vendore merr masa që të mënjanojë çdo veprim apo sjellje që shkel dinjitetin dhe të drejtat e njeriut për jetë dhe siguri të personave të prekur.

9.4. Njësia përgjegjëse për ekzekutimin e aktit administrative të zhvendosjes merr masa që gratë e vajzat të mos i nënshtrohen dhunës me bazë gjinore dhe diskriminimit gjatë zhvendosjes dhe që të drejtat e njeriut të fëmijëve të mbrohen.

9.5. Në rastet kur paraqitet e nevojshme, çdo përdorim i ligjshëm i forcës duhet të jetë në respektim të parimeve të nevojës dhe proporcionalitetit. Punonjësit e zbatimit të ligjit nuk tejkalojnë asnjë parim bazë të përdorimit të forcës dhe respektojnë legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve.

9.6. Nuk lejohet asnjë zhvendosje të ekzekutohet në mot të keq, gjatë orarit 19.00 pasdite deri 7.00 të mëngjesit, gjatë festave ose pushimeve fetare, gjatë fushatave zgjedhore ose

edhe gjatë ose deri dy muaj përpara provimeve përfundimtare të shkollës.

9.7. Gjatë ekzekutimit të zhvendosjes, njësia përgjegjëse dhe të gjithë punonjësit e zbatimit të ligjit marrin masa për të garantuar që askush të mos jetë objekt i sulmeve direkte ose pa dallim, ose akteve të tjera të dhunës, veçanërisht ndaj grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuar, moshës së tretë, ose për të garantuar që askush të mos privohet në mënyrë arbitrare nga pronat ose zotërimet për shkak të shembjeve, zjarrit dhe formave të tjera të shkatërrimit të qëllimshëm, neglizhencës ose çdo forme dënimi kolektiv.

9.8. Punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore si dhe punonjësit e tjerë të përfshirë në procesin e zhvendosjes marrin masa që prona dhe zotërimet e lëna pas në mënyrë të pavullnetshme nga individit/familja që zhvendoset, të mbrohen nga shkatërrimi dhe përvetësimi arbitrar dhe i paligjshëm, zënia ose përdorimi i tyre.

9.9. Gjatë ekzekutimit të zhvendosjes, njësia përgjegjëse dhe të gjithë punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore si dhe cilido punonjës i përfshirë në procesin e zhvendosjes nuk u kërkohen në asnjë rast të dëbuarve, ose nuk i detyrojnë ata, të shembin banesat e tyre ose struktura të tjera. Nëse kjo lehtëson rikuperimin e zotërimeve dhe materialit të ndërtimit, personave të zhvendosur duhet t'u jepet mundësia për ta bërë një gjë të tillë.

10. Njësia e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për investimin publik, subjekti privat apo cilido organ publik përgjegjës për sigurimin e kompensimit të drejtë dhe strehimit të përshtatshëm alternativ, ose kthimin, kur është e mundur, duhet ta bëjë këtë para zhvendosjes, përveç rasteve të forcës madhore. Minimalisht, pavarësisht kushteve dhe pa diskriminim, autoritetet kompetente duhet të garantojnë që personat ose grupet e zhvendosura, veçanërisht ata që nuk mund të mbajnë veten, të kenë akses të sigurt dhe të mbrojtur në: (a) ushqim, ujë të pijshëm dhe higjienë bazë; (b) strehim dhe akomodim bazë; (c) veshje të përshtatshme; (d) shërbime mjekësore bazë; (e) burime jetese; (f) ushqim për bagëtinë dhe akses në burime të pronës së përbashkët nga të cilat vareshin dikur dhe (g) arsim për fëmijët dhe ambiente për kujdesin ndaj fëmijëve. Njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të garantojnë gjithashtu se anëtarët e të njëjtës familje të mos ndahen për shkak të zhvendosjeve.

11. Njësia e vetëqeverisjes vendore garanton pjesëmarrjen e barabartë të vajzave e grave në të gjitha proceset e planifikimit dhe shpërndarjen e shërbimeve dhe furnizimeve bazë.

12. Në rastet e zhvendosjes, njësia e vetëqeverisjes vendore siguron ose garanton kompensim të drejtë për çdo humbje të pronës me karakter pasuror dhe pronësor të lidhur me titujt pronësie si dhe sende personale.

12.1 Kompensimi ofrohet edhe për çdo dëm efektiv dhe fitimin e munguar, pasuror e moral që lidhet me shëndetin e dinjitetin e personave, sipas rastit dhe në përpjesëtim me rëndësinë e shkeljes dhe rrethanat për secilin rast.

12.2. Në asnjë rast kompensimi financiar nuk duhet të zëvendësojë kompensimin real në formën e tokës dhe burimeve të pronës së përbashkët. Në rastet e marrjes së tokës, individët/familjet i nënshtrohen kompensimit të drejtë në përputhje me ligjin në fuqi për shpronësimet për interes publik.

12.3. Të gjithë të zhvendosurit, kanë të drejtë kompensimi për humbjen, rikuperimin dhe transportin e sendeve dhe pronave të prekura, përfshirë banesën fillestare, tokën e humbur

ose të dëmtuar gjatë procesit dhe çdo pasuri të luajshme të dëmtuar gjatë zhvendosjes. Për çdo zhvendosje mbahet një procesverbal i identifikimit të pasurive të luajshëm dhe të paluajshme. Marrja në shqyrtim e rrethanave për çdo rast duhet të mundësojë ofrimin e kompensimit për humbjet që lidhen me pronën informale, si për shembull barakat.

12.4. Në rastin e zhvendosjes së familjeve, të dy bashkëshortët janë bashkë-përfitues për të gjitha paketat e kompensimeve të identifikuarra për rastin.

12.5. Në vlerësimin e dëmit ekonomik njësia e vetëqeverisjes vendore merr në konsideratë humbjet dhe kostot, për shembull, të parcelave të tokës dhe strukturave të banimit; përmbajtja; infrastruktura; hipotekat ose penaltete të tjera të lidhura me borxhet; strehimi i përkohshëm; tarifat për shërbimet e zyrave të shtetit dhe ato ligjore; strehimi alternativ; pagat dhe të ardhurat e pakta; mundësitë e munguara për arsim; kujdesi shëndetësor dhe mjekësor; kostot e risistemimit dhe transportit (veçanërisht në rast rivendosjeje larg nga burimi i jetesës). Në rastet kur banesa dhe toka sigurojnë një burim jetese për banorët e dëbuar, vlerësimi i ndikimeve dhe humbjeve duhet të përfshijë edhe vlerën e humbjeve të biznesit, pajisjeve/inventarit, bagëtisë, tokës, pemëve/kulturave, dhe pagat/të ardhurat e munguara/të zvogëluara.

13. Kur kushtet e lejojnë, njësia e vetëqeverisjes vendore i jep përparësi të rikthimit e pronës tek të gjithë personat, grupet dhe komunitetet që i nënshtrohen zhvendosjeve të detyruara. Personat, grupet dhe komunitetet nuk detyrohen kundër vullnetit të tyre të kthehen në shtëpitë, tokat apo vendet e origjinës së tyre nga të cilat janë zhvendosur.

13.1. Personat, grupet dhe komunitetet që zhvendosen nga prona për të cilën gëzojnë tagrin e pronësisë, mbi të cilën do të investohet përsëri me banesa apo ambiente të tjera kanë të drejtën të përfitojnë të parët nga kthimi dhe rikthimi.

13.2. Në rastet kur kthimi është i mundur ose nuk ofrohet risistemimi i përshtatshëm në pajtim me rregullat e detajuara në këtë vendim, autoritetet kompetente duhet të përcaktojnë kushte dhe të sigurojnë mjetet, përfshirë ato financiare, për kthimin vullnetar, të sigurt dhe të mbrojtur dhe me dinjitet, në banesat ose vendbanimet e zakonshme.

13.3. Njësia përgjegjëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore lehtëson riintegrimin e personave të kthyer dhe përpiqet për të garantuar pjesëmarrjen e plotë të personave, grupeve dhe komuniteteve të prekura në proceset e planifikimit dhe menaxhimit të kthimit. Autoritetet përgjegjëse marrin të veçanta për të garantuar pjesëmarrjen e barabartë dhe efikase të vajzave/grave në proceset e kthimit ose të kthimit të pronave për të kapërcyer paragjykimet ekzistuese familjare, të komunitetit, institucionale, administrative, ligjore ose të llojeve të tjera, të cilat kontribuojnë në marginalizimin ose përjashtimin e grave/vajzave.

13.4 Njësia e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes qendrore kanë detyrën dhe përgjegjësinë t'i ndihmojnë personat, grupet ose komunitetet që kthehen për të rikuperuar maksimalisht pronën dhe zotërimet që kanë lënë pas ose nga të cilat janë shpronësuar gjatë zhvendosjes së tyre.

13.5. Nëse kthimi në vendbanim ose rikuperimi i pronës dhe zotërimeve nuk është i mundur, autoritetet përgjegjëse duhet t'u ofrojnë ose t'i ndihmojnë të zhvendosurit që të marrin kompensimin e duhur ose forma të tjera kompensimi të drejtë.

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore i japin përparësi të drejtës së individit/familjes së zhvendosur për t'u kthyer, ose kur rrethanat e pamundësojnë këtë, krijojnë kushtet e risistemimit të personave, grupeve dhe komuniteteve të veçanta për shkak të zhvendosjeve

- për interes publik. Ky risistemim duhet të kryhet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.
15. Kundër vendimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për zhvendosje nga banesa, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.
17. Njësia e vetëqeverisjes vendore njofton ministrinë përgjegjëse për çështjet e qeverisjes vendore, ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, si dhe të strehimit për çdo procedurë zhvendosjeje, menjëherë me fillimin e identifikimit të nevojës për zhvendosje. Ky njoftim është i detyrueshëm edhe kur shkaku i zhvendosjes identifikohet nga një institucion qendror.
18. Institucionet qendrore në rastet kur identifikojnë nevojën për zhvendosje, njoftojnë njësinë e vetëqeverisjes menjëherë me miratimin/hartimin e projektit për shkak të të cilit identifikohet nevoja për zhvendosje.
19. Njësia e vetëqeverisjes vendore njofton Policinë e shtetit dhe Policinë Bashkiake për do procedurë zhvendosjeje dhe kërkon, sipas rastit mbështetjen e tyre gjatë procedurës së zhvendosjes. Policia Bashkiake dhe ajo e Shtetit lidhin një marrëveshje bashkëpunimi për koordinimin e veprimeve mes tyre.
20. Avokati i Popullit njoftohet për çdo procedurë zhvendosjeje të nisur nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim marrjen e masave për monitorimin e kësaj procedure. Avokati i Popullit ka të drejtën të realizojë një raport me gjetjet e monitorimit të procedurës së zhvendosjes. Raporti vendoset në faqen e internetit të këtij institucioni / njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në rastin kur konstatohen shkelje prej tij, përgatiten rekomandimet e nevojshme.
21. Njësia e vetëqeverisjes vendore njofton Prefektin e qarkut për çdo procedurë zhvendosjeje që ndodh brenda juridiksionit të prefektit.
22. Procedurat e zhvendosjeve janë të hapura për organizatat e shoqërisë civile. Njësia e vetëqeverisjes vendore ku zhvillohet procedura e zhvendosjes bën një njoftim publik përmes të cilit fton organizatat e shoqërisë civile të interesuara të ndjekin procedurën e zhvendosjes. Cdo raportim raport i hartuar nga organizatat e shoqërisë civile për procedurën e zhvendosjes i dorëzohet njësisë së vetëqeverisjes vendore.
23. Ky Vendim hyn në fuqi me botimin në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama